



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 756/6 Prot.

Tiranë, më 26.09.2025

V E N D I M

Nr. 225, Datë 26.09.2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 112, datë 09.05.2025, e znj. K.M, e përfaqësuar nga djali i saj F.M¹, kundër Bashkisë Has/Sektori i Ndhmës Ekonomike dhe përkujdesjes sociale, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes ekonomike” dhe “çdo shkak tjetër²”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi³,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “Znj. K.M është banuese në Has dhe përfituese e pensionit familjar në masën 50% të pensionit të bashkëshortit të saj të ndjerë.

Prej 9 vitesh ka qenë përfituese e ndihmës ekonomike për shkak të papunësisë. Në muajin mars 2025, ndodhi një ndërprerje e papritur dhe pa verifikim të drejtë të ndihmës ekonomike nga Bashkia Has, me pretendimin se nëna ime nuk jeton në Has. Nëna aktualisht është regjistruar në gjendjen civile në Has, por për arsye familjare, duhet të lëvizë disa herë në muaj, sa në Has sa në Tiranë.

Dëshiroj të nënvizoj se kjo ndërprerje nuk është rastësi. Mua (F.M) më është ndërprerë më parë ndihma ekonomike në mënyrë të padrejtë dhe pas ankesave në disa institucione, përfshirë edhe tek Avokati i Popullit, arrita të fitoja sërish të drejtën e përfitimit. Gjatë kësaj periudhe, jam

¹ Referuar deklaratës me shkrim datë 09.05.2025 të znj. K.M.

² Si formë hakmarrje, për shkak të ankesave që ka bërë djali i saj F.M, kur i kanë ndërprerë ndihmën ekonomike.

³ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

përballur me qëndrime të hapura hakmarrëse nga përgjegjësjë e ndihmës ekonomike në Bashkinë Has, znj. F.Q. Kjo e fundit më është përgjigjur se: “Ose do përfitosh ti, ose nëna jote - jo të dy sa të jem unë në këtë pozicion”. Kjo është një deklaratë që tregon qartë qëllimin personal dhe hakmarrës që ka çuar në ndërprerjen e padrejtë të ndihmës ekonomike për nënën time.

Theksoj gjithashtu se asnjëherë nuk është kryer verifikim në terren nga Bashkia Has, për të konstatuar vendbanimin real të nënës time, gjë që do të duhej të ishte pjesë e procesit të vlerësimit për përfitimin. As unë, as nëna ime dhe as ndonjë familjar tjetër që jeton në banesën tonë në Has, nuk kanë parë ndonjë përfaqësues të Bashkisë për këtë qëllim.

Aktualisht jam unë që po merrem me problematikën e nënës time dhe kam qenë dhe në mbledhjen e Këshillit Bashkiak të Bashkisë Has ku është diskutuar dhe miratimi i listës së përfituesve të ndihmës ekonomike. E kam ngritur këtë problematikë vetë në këtë mbledhje dhe përgjegjësjë F.Q është shprehur se nëna ime nuk jeton në Has dhe prandaj i është ndërprerë ndihma ekonomike, duke e ditur shumë mirë që arsyeja e vërtetë është se e ka marrë shumë personale dhe po hakmerret në mënyrë që të përmbushë egon e saj.

Në një moment, znj. F.Q më thirri në zyrë dhe më pyeti nëse kam vazhduar ankimin ndaj saj tek Avokati i Popullit. Unë ja konfirmova që po e vazhdoj çështjen dhe ajo më tha që nuk keni më punë te zyra e saj dhe që të pres një përgjigje te Avokati i Popullit. Gjithashtu znj. F.Q ka marrë në telefon motrën time dhe ja përcolli informacionin që nënës tonë nuk i takon ndihma ekonomike për shkak se ajo aktualisht jeton në Tiranë. Pavarësisht shpjegimeve të motrës që nëna jonë shkon e vjen, ajo këmbënguli që nëna jonë nuk mund të trajtohet me ndihmë ekonomike. Bashkia Has disa herë ka shpërfillur kërkesat e mia duke refuzuar për të diskutuar në Këshill, kërkesat e nënës sime për marrjen e ndihmës ekonomike”.

Në përfundim, subjekti ankues kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe përfitimin e ndihmës ekonomike.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën e sipërcituar, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i atribuon të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të “gjendjes ekonomike” dhe “çdo shkak tjetër” duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose

martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Neni 5, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikon ndalimin e diskriminimit për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji. Sipas këtij neni ndalohet gjithashtu mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, të një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje, që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Neni 7, i LMD, të ndryshuar, parashikon shprehimisht: “1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. 3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre”.

Në Kreun III, të ligjit të sipërcituar parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Ky ligj në nenin 20, pika 1, të tij parashikon se: “1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi”.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 756/1, datë 20.05.2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga Bashkia Has, lidhur me pretendimet e subjektit ankues, si dhe ka kërkuar dokumentacionin si më poshtë:
 - Kopje të praktikës shkresore/procedurës së ndjekur, lidhur me rastin e znj. K.M.
 - Informacion, nëse ka praktika të njëjta apo të ngjashme për persona të ndodhur në kushte të njëjta apo të ngjashme me ankuesen, për të cilët nga ana juaj është ndjekur e njëjta

praktikë. Kopje të praktikave të ngjashme. (Për subjekte të cilët kanë të njëjtën situatë si ankuesja/procedura e ndjekur prej jush për raste specifike).

- Informacion nëse ankuesja (Znj. K.M) ka depozituar ankesë pranë institucionit tuaj, lidhur me çështjet që janë objekt ankese.
- Informacion dhe kopje të ankesave të bëra nga z. F.M, lidhur me ndërprerjen dhe ripërfitimimin e ndihmës ekonomike.
- Kopje të vendimit të Këshillit Bashkiak Has, lidhur me miratimin e kriterëve për përfitimimin e ndihmës ekonomike për aplikuesit për përfitim nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike.

Me shkresën nr. 1702/1, datë 26.05.2025, Bashkia Has, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Në përgjigje të shkresës ku kërkohet informacion në lidhje me rastin e znj. K.M, ju bëjmë me dije ecurinë e aplikimit të familjes, që nga periudha kur është bërë aplikimi në sistemin elektronik, për të pasur një panoramë më të detajuar të rastit:*

Familja e znj. K.M është refuzuar për përfitim nga ndihma ekonomike në muajin shkurt 2018, për shkak të mosdeklarimit të pagës nga vajza e saj. Struktura familjare në atë kohë përbëhej nga tre anëtarë: Znj. K.M (kryefamiljare); S.M (djali), datëlindja 20.05.1996; H.M (vajza), datëlindja 10.03.1994.

Në korrik 2018 është kryer një aplikim i ri në sistem, tashmë vetëm me dy anëtarë: znj. K.M dhe djali S.M. Aplikimi rezultoi me pikë të pamjaftueshme për përfitim nga ndihma ekonomike.

Nga janari 2019 deri në janar 2021, familja është trajtuar me ndihmë ekonomike në vlerën mujore prej 3.060 lekë. Në janar 2021, aplikimi është refuzuar sërish, këtë herë për shkak të mosdeklarimit të një automjeti.

Në shtator 2021 është kryer një aplikim i ri në sistemin e ndihmës ekonomike, ku familja rezulton përfituese deri me 1 qershor 2022.

Në gusht 2022, pas rekomandimit të administratores sociale znj. E.A dhe me miratimin e Këshillit Bashkiak, familja është trajtuar me fondin shtesë 6%, deri në janar 2023.

Më pas, në mars 2023 është përsëritur aplikimi në sistemin elektronik, ku për muajin prill 2023 deri në shkurt 2025, familja është trajtuar vazhdimisht me fondin 6%.

Në muajin mars 2025, bazuar në kriteret e përcaktuara nga Bashkia Has për përfitimimin e fondit shtesë 6% dhe kufizimet buxhetore të muajit përkatës, si dhe pas verifikimeve nga administratorët socialë, rezultoi se znj. K.M nuk kishte dokumentacion të plotë në përputhje me ligjin për ndihmën ekonomike për vitin 2024. Ajo është njoftuar që të dorëzojë dokumentacionin përkatës me qëllim që të kryej aplikimi i radhës, praktikë kjo e ndjekur edhe më herët për rastin e zonjës dhe gjithashtu një praktikë e ndjekur zakonisht për të gjithë përfituesit nga fondi i kushtëzuar 6%.

Djali i saj, z. F.M, i cili nuk është pjesë e certifikatës familjare me znj. K.M, ka dorëzuar disa dokumente pas datës 10.04.2025. Ndërkohë, administratorët socialë e kanë njoftuar znj. K.M që të paraqitet pranë Sektorit të Ndihmës Ekonomike, gjatë datave 1-10 maj 2025, për të kryer aplikimin e radhës. Sipas të dhënave zyrtare, znj. K.M nuk është paraqitur në afatin e përcaktuar.

Në përfundim, sqarojmë se përjashtimi i përkohshëm i familjes, nga trajtimi me fondin 6% në muajin mars 2025, është bërë në përputhje me kriteret ligjore dhe administrative të Bashkisë Has dhe si pasojë e mungesës së dokumentacionit të domosdoshëm në afatin e njoftuar”.

Në zbatim të parimit të kontradiktoritetit e transparencës, për një gjykim sa më të drejtë të çështjes, përfaqësuesi i ankueses nëpërmjet e-mail-it datë 28.05.2025, është njohur me përgjigjen e Bashkisë Has.

Në përgjigje të informacionit të dërguar nga Bashkia Has, përfaqësuesi i ankueses me email-et datë 02.06.2025 dhe datë 09.06.2025, në mes të tjerash informoi si vijon: “Unë, Znj. K.M, prej vitesh trajtohem rregullisht me ndihmën ekonomike dhe jam në kushte të vështira sociale. Për rastin tim si aplikante për ndihmë ekonomike në një situatë të rënduar ekonomike e sociale, sqaroj se mjetet që marrim janë të pamjaftueshme për të mbuluar nevojat bazë të jetesës. Pas kësaj djali im i vogël u detyrua të largohej nga Hasi për të mos mbetur pa punë, dhe nisi punë në Tiranë si lavazhier.

Pas kësaj, vajza ime H.M u diagnostikua me tumor dhe jemi ndodhur në një gjendje shumë të rënduar psikologjike dhe ekonomike. Vajza ime vazhdon ende sot të trajtohet për këtë sëmundje. Për shkak të përkeqësimit të shëndetit të saj dhe për shkak të ndarjes së djalit tim të madh F.M nga bashkëshortja, vajza u kthye në Has për t’u kujdesur për nipin dhe jeton aktualisht në shtëpi, bashkë me F.M. Ndërsa unë ndodhem herë në Tiranë me S.M, për arsye shëndetësore dhe ekonomike, dhe herë në Has, për të ndihmuar familjen.

Konflikti me znj. F.Q ka nisur më shumë se një vit më parë, kur ajo i hoqi ndihmën ekonomike djalit tim F.M, pa asnjë arsye ligjore, vetëm sepse ai shprehu bindjet e tij politike. Kjo u kthye në një formë hakmarrjeje ndaj tij, dhe madje porsa F e denoncoi rastin tek Avokati i Popullit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror dhe më tej, tek Ministria e Drejtësisë, znj. Q i ka thënë djalit tim F: “O ti, o nëna jote, dy kurora nuk mund të trajtohen me ndihmën ekonomike”.

Asnjëherë nuk na ka ardhur ndonjë përfaqësues i bashkisë ose i shërbimeve sociale që të verifikojë gjendjen time ekonomike. Kurrë nuk kanë qenë te shtëpia dhe kurrë nuk na kanë thirrur për t’u paraqitur tek zyra e shërbimeve sociale të bashkisë, për të verifikuar rastin tonë familjar, ose për të firmosur, ose për të na kërkuar dokumente, siç e parashikon ligji, ose për të na vënë në dijeni.

Në muajin shkurt, znj. Q e thirri djalin tim F, për të firmosur për trajtimin e tij nga fondi i posaçëm 6% dhe i dërgoi emrin në Këshillin Bashkiak. Në shkurt 2025, ndihma ekonomike për djalin tim, u rikthye.

Por në mars 2025, znj. Q në mënyrë të qëllimshme futi emrin tim në Këshillin e Bashkisë duke pretenduar se nuk banoj në Has, ndaj nuk kam të drejtë ndihme. Ajo justifikoi refuzimin tim me faktin që nuk kam ardhur personalisht për të firmosur. Në mbledhjen e datës 26.05.2025, çështja ime është diskutuar dhe nuk ju dha asnjë rezultat, në rrugë ligjore.

Unë, Znj. K.M, kam qenë vetë për të firmosur dhe mu kërkua që të sillja disa dokumente. Djali im i dorëzoi, por më pas më thanë që duhet të paraqitesha vetë. Kur shkova, më kërkuan të sillja edhe një vërtetim nga Policia e Rendit, që nuk kisha kaluar kufirin, gjatë 6 muajve të fundit. Edhe pse dorëzuam të gjitha dokumentet, përsëri nuk u pranua kërkesa ime, për arsye të padrejta dhe për të justifikuar veprimin e saj duke më thënë nga data 1 deri me datë 10. Këshilli i Bashkisë ka thënë se do verifikojë dokumentet “hap pas hapi”. Por unë shpreh se këto veprime të qëllimshme dhe të motivuara për hakmarrje dhe politikisht, vetëm për të arsyetuar veprimet e saj znj. Q”.

Me email-in datë 17.06.2025, përfaqësuesi i ankueses, në mes të tjerash informoi si vijon: “Sot kam mësuar se përgjegjësja e sektorit të ndihmës ekonomike dhe përkujdesjes sociale të Bashkisë Has, znj. F.Q është transferuar nga shërbimi social dhe është emëruar si përgjegjëse e sektorit të tatim taksave, pranë Bashkisë Has. Ajo është zëvendësuar nga z. D.Ç”.

Me email-in datë 22.07.2025, Inspektori i çështjes ka kërkuar nga përfaqësuesi i ankueses kopje të certifikatës familjare dhe të vërtetimit të trajtimit me pension. Nuk ka përgjigje.

Me shkresën nr. 756/3, datë 24.07.2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar informacion dhe dokumentacion shtesë nga Bashkia Has.

Me shkresën nr. 2579/1, datë 27.08.2025, Bashkia Has, ka informuar si vijon: “Me datë 27.06.2025 specialistët e Sektorit të Ndihmës Ekonomike në Bashkinë Has kanë shkuar për vizitë në familjen e znj. K.M, e cila është vënë në dijeni paraprakisht, por nuk është gjendur asnjë familjar në shtëpi. Kemi bërë gjithë procedurën e nevojshme dhe e kemi nisur me shkresën nr. 2180, datë 27.06.2025, Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Kukës. Në vizitën e kryer në shtëpi nuk është gjetur asnjë anëtar i familjes”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë dhe të pafavorshëm të ankueses.

Ligji nr. 57, datë 18.07.2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, zbatohet për individët, familjet në nevojë, personat me aftësi të kufizuara në Republikën e Shqipërisë dhe nënat me foshnja të porsalindura, për ofrimin dhe garantimin e asistencës sociale.

Neni 7 i këtij ligji parashikon shprehimisht se:

“Përfituesit e ndihmës ekonomike janë:

- a. familjet në nevojë, që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme;*
- b. c. ç. d. ”.*

Neni 15, pika 1, të ligjit të sipërcituar parashikohen dhe rastet e përjashtimit nga ndihma ekonomike, si më poshtë:

“1. Përjashtohen nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë gjashtëmujore familjet, të cilat kanë në përbërje të tyre edhe një anëtar të vetëm, që plotëson kushtet e mëposhtme:

a) kryen ndarje të qëllimshme të anëtarëve të familjes që jetojnë në të njëjtën strehë, kur nuk krijohet një kurorë e re, me përjashtim të rastit vajzë-nënë;

b) nuk tërheq ndihmën ekonomike brenda afateve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, me përjashtim të rasteve kur kjo ka ndodhur për shkaqe të arsyeshme, si shëndetësore apo fatkeqësi;

c) refuzon verifikimin e situatës social-ekonomike në familje;

ç) fsheh informacionin apo kryen deklarin të rremë;

d) nuk paraqiten për deklarin dhe/ose nuk deklarojnë ndryshimet e situatës social-ekonomike çdo tre muaj pranë administratorit shoqëror, me përjashtim të rasteve kur kjo ka ndodhur për shkaqe të arsyeshme, si shëndetësore apo fatkeqësi, dhe të anëtarëve të familjes, të cilët janë persona me aftësi të kufizuara, invalidë pune ose të moshuar, të cilët janë në pamundësi lëvizjeje; dh) e).. ”.

Kategoritë e individëve që mund të aplikojnë për të përfutuar ndihmë ekonomike, si dhe mënyrën se si bëhet pranueshmëria në skemën e ndihmës ekonomike, përcaktohet shprehimisht në nenin 16, pikat 1-3, të ligjit të sipërcituar, ku parashikohet se:

1. Kërkesa për të përfutuar ndihmë ekonomike bëhet nga:

a) kryetari i familjes ose njëri nga anëtarët madhorë të familjes, së bashku me bashkëshortin/en ose i vetëm, kur nuk ka bashkëshort/e;

b) secili prej bashkëshortëve, në rastet kur ata janë në proces zgjidhjeje martese dhe nuk ka ende vendim gjykatë të formës së prerë;

c) nga vetë individi, sipas përcaktimeve në shkronjat “b”, “ç” e “d”, të nenit 7.

2. Aplikimi për të përfituar ndihmë ekonomike bëhet tek administratori shoqëror në njësinë administrative, nën juridiksionin e së cilës ka vendbanimin. Kriteret, procedura dhe dokumentacioni për përfitimin e ndihmës ekonomike, si dhe masa e përfitimit të saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Pranueshmëria në skemën e ndihmës ekonomike bëhet nëpërmjet formulës së pikëzuar, treguesit e së cilës mbajnë parasysh gjendjen e varfërisë. Treguesit e vlerësimit të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e ndihmës ekonomike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Në nenin 21, të ligjit sipërcituar, përcaktohet roli i Këshillit Bashkiak: “Këshilli bashkiak miraton kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit, bazuar në vlerësimin social-ekonomik të kryer nga administratori shoqëror. Familjet në nevojë trajtohen nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike, duke përfshirë ose jo edhe fonde të buxhetit vendor. Përdorimi i fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Në zbatim të ligjit nr. 57, datë 18.07.2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” është miratuar Vendimi nr. 597, datë 04.09.2019, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”.

Kreu I, pika 2, germa a), e VKM-së 597/2019, sipërcituar, përcakton se: “...përfituesit e ndihmës ekonomike janë...(a) familjet në nevojë, që nuk kanë të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme”.

Ndër të tjera, në këtë VKM, në Pjesën II përcaktohet edhe procedura e aplikimit për ndihmë ekonomike, në të cilën parashikohet se: “1. Administratori shoqëror identifikon familjet dhe individët në nevojë, i informon ata mbi procedurat e aplikimit dhe të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe i fton ata për aplikim. Administratori shoqëror, në prani të kryetarit të familjes/anëtarit madhor, së bashku me bashkëshortin/en, ose të vetëm kur nuk ka bashkëshort/e, kur aplikon për ndihmë ekonomike, hedh në Regjistrin Elektronik Kombëtar, brenda 10 (dhjetë) ditëve të para të muajit, të dhënat e mëposhtme: a) Formularin për aplikim për ndihmë ekonomike, sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si pjesë përbërëse e tij, dhe që përmbledh informacionin për: i) demografinë e familjes, arsimin dhe punësimin; ii) llojin e banesës; iii) pasuritë/asetet familjare; iv) të ardhurat nga programet e mbrojtjes shoqërore dhe të ardhurat e tjera. Njëkohësisht, 2. Administratori shoqëror, pasi verifikon situatën social ekonomike të familjeve në nevojë nëpërmjet vizitave në familje dhe në terren, brenda muajit të aplikimit për familjet që aplikojnë për herë të parë si dhe dy herë në vit për të gjitha familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike, hedh në Regjistrin Elektronik Kombëtar të dhënat sipas formularit në shtojcën 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. 3. Administratori shoqëror paraqet pranë strukturës përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki, nëpërmjet Regjistrit Elektronik Kombëtar, listën e familjeve/individëve në nevojë që kanë aplikuar për ndihmë

ekonomike; 4. Anëtarët madhorë të familjes/individët përfitues paraqiten çdo 3 (tre) muaj pranë administratorit shoqëror për të deklaruar lidhur me gjendjen social-ekonomike të familjes. Administratori shoqëror hedh në Regjistrin Elektronik Kombëtar deklaratën lidhur me ndryshimet e situatës social-ekonomike të familjes, sipas shtojcës 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për përfitimin e ndihmës ekonomike. 5. ”.

Në Kreun IV, të kësaj VKM-je, parashikohet se: “1. Këshilli bashkiak miraton në fillim të vitit kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese për ndihmë ekonomike, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit dhe që do të trajtohen me fondin shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmë ekonomike. 2. ... 3. 4. 5. 6. 7. Për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike duhet të jetë kryer paraprakisht vlerësimi social-ekonomik në familje nga administratori shoqëror, sipas shtojcës 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi. 8. Administratori shoqëror, gjatë periudhës së trajtimit me fondin deri 6 për qind, nëse verifikon që ka ndryshime të situatës social ekonomike, referon familjen për të aplikuar në Regjistrin Elektronik Kombëtar të Ndihmës Ekonomike apo ndërpret periudhën e përfitimit në rast të punësimit të anëtarëve të familjes. 9..... “.

Për sa më sipër, rezulton se familja e znj. K.M, ka aplikuar disa herë për ndihmë ekonomike dhe ka qenë përfituese në aplikimet e muajit korrik 2018, janar 2019, shtator 2021 dhe i është refuzuar aplikimi për ndihmë ekonomike në periudhën qershor 2022.

Nga analizimi i akteve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara refuzimi i ankueses (qershor 2022) për të qenë përfituese e ndihmës ekonomike është kryer nga sistemi përkatës i pikëzimit, i cili e bën përzgjedhjen në mënyrë automatike të familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike. Kriteret dhe vlerësimin përkatës e bën sistemi dhe në asnjë rast subjekti kundër së cilës drejtohet ankesa.

Pavarësisht sa më sipër, ligjvënësi ka përcaktuar mënyra alternative për të ndihmuar ato familje që nuk rezultojnë përfituese të ndihmës ekonomike nga sistemi i pikëzimit, duke i trajtuar me fondin shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike. Kështu në Pjesën IV, të Vendimit nr. 597/2019, të Këshillit të Ministrave, Këshilli Bashkiak miraton në fillim të vitit kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese për ndihmë ekonomike, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit dhe që do të trajtohen me fondin shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike.

Në kushtet kur ankuesja është refuzuar nga sistemi elektronik i pikëzimit për të qenë përfituese e ndihmës ekonomike, si dhe duke qenë në dijeni të gjendjes së saj ekonomike, administratorja sociale e Bashkisë e ka rekomanduar znj. K.M për të përfituar ndihmë ekonomike me fondin shtesë 6% të Bashkisë dhe është shpallur fituese për periudhën gusht 2022 deri në janar 2023. Më pas, në periudhën mars 2023, ankuesja ka përsëritur aplikimin dhe është shpallur përfituese me fondin shtesë 6%, për periudhën prill 2023 deri në shkurt 2025.

Referuar Vendimit nr. 23, datë 26.03.2025, të Këshillit të Bashkisë Has *“Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për Bllok-Ndihmës deri 6% për muajin shkurt 2025”*, rezulton se znj. K.M ka qenë përfituese e ndihmës ekonomike për muajin shkurt 2025, në masën 3.703 lekë.

Nga analizimi i akteve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara rezulton se, administratorët shoqërorë luajnë një rol kyç në zbatimin e legjislacionit për asistencën sociale. Ata janë përgjegjës për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, si dhe për verifikimin e statusit socio-ekonomik të individëve dhe familjeve.

Referuar akteve ligjore të sipërcituara, VKM 597/2019, rezulton se administratorët shoqërorë kanë detyrimin për të bërë verifikime për ndryshime të situatës social-ekonomike të familjeve/individëve aplikues (pika 7 dhe 8, Kreu IV) dhe hedhjen në Regjistrin Elektronik Kombëtar të të dhënave të aplikuesve, brenda 10 ditëve të para të muajit (pika 1, Kreu II).

Referuar informacioneve të palëve rezulton se nga verifikimi i dokumenteve të dosjes së ankueses për vitin 2024, kishte mungesa në dokumentacion dhe për këtë arsye i është ndërprerë dhe ndihma ekonomike ankueses për periudhën e muajit mars 2025. Referuar deklarimeve të palëve rezulton se ankuesja është njoftuar për të plotësuar dokumentacionin e dosjes, dhe djali i znj. K.M ka dorëzuar dokumentacionin pas datës 10 prill 2024. Gjithashtu, znj. K.M është njoftuar që të paraqitet pranë Sektorit të Ndihmës Ekonomike gjatë datave 1-10 maj 2025, për të plotësuar formularin e aplikimit, por nuk është paraqitur.

Referuar procesverbalit datë 27.06.2025 të mbajtur nga specialistët e Sektorit të Ndihmës Ekonomike të Bashkisë Has, E.Sh dhe B.A, rezulton se ata kanë vajtur në banesën e znj. K.M në datë 27.06.2025, për të plotësuar Formularin e verifikimit të situatës social-ekonomike të ankueses, por nuk është gjetur asnjë anëtar i familjes në banesë.

Fakti i lëvizjes të herëpashershme znj. K.M nga qyteti i Hasit drejt Tiranës, është pranuar dhe nga vetë ajo, kur deklaron se për arsye shëndetësore, ekonomike dhe për të ndihmuar familjen ndodhet herë në Tiranë dhe herë në Has.

Znj. K.M, për vetë faktin se ka aplikuar shumë herë për përfitimin e ndihmës ekonomike, është e vetëdijshme për procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm që kërkohet për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe megjithatë nuk ka marrë hapat e nevojshëm për plotësimin e saktë dhe në kohë të këtij dokumentacioni, gjë që solli këto pasoja. Kjo situatë çoi në përjashtimin e familjes nga ndihma ekonomike, pasi plotësimi i dokumentacionit në kohë është një kriter i rëndësishëm për të përmbushur kërkesat ligjore dhe administrative për të pasur akses në mbështetje financiare.

Diskriminimi përkufizohet në nenin 3, pika 1 të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të*

njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në nenin 20/1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet: “1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato: a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi”.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se subjekti ankues nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e subjektit ndaj të cilit ka paraqitur ankesën.

Në mungesë të këtij trajtimi, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Bashkisë Has/Sektori i Ndihmës Ekonomike, për shkaqet e pretenduara nga ankuesja dhe për rrjedhojë nuk provohet se Bashkisë Has/Sektori i Ndihmës Ekonomike, kanë shkelur dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 32 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të znj. K.M nga ana e Bashkisë Has/Sektori i Ndihmës Ekonomike.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA